



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

ZYRA E KRYETARIT

01Nr. 21/2026

13.01.2026

Zyra e Kryetarit, Komuna e Istogut në bazë të rregullores të Komunës së Istogut Nr. 146/2025 për ndarjen e Subvencioneve si dhe në bazë të rregullores MF – Nr. 04/2017 për kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve shpallë:

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e :

- 1. Shërbimin e rehabilitimit të bazuar në bashkësi Psiko-Terapi dhe Fizio-Terapi për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe**
- 2. Aftësimi i personave të verbër në teknologji informatike dhe braj.**
- Komuna e Istogut u bënë thirrje organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Komunën e Istogut dhe programi i punës i cili është i fokusuar në fushën përkatëse të aplikojnë për mbështetje financiare.
- OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e cekura në thirrje.

OJQ-të duhet ti sjellin këto dokumentacione:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së.
2. Certifikata e nr. Fiskal.
3. Vërtetimin/konfirmimin e Llogarisë bankare të lëshuar nga banka përkatëse (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).
4. Kopjen e letërnjoftimit të drejtuesit të OJQ-së apo dokument tjetër identifikues valid.
5. Vërtetimin nga ATK, që dëshmon se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore.
6. Vërtetimin nga gjykata që OJQ-ja nuk është në procedurë të shuarjes apo çregjistrimit.
7. Aplikacionet : në bazë të rregullores MF – Nr. 04/2017.

KRITERET PËR PJESËMARRJE NË THIRRJEN PUBLIKE PËR SUBVENCION, SI DHE KRITERET E PRANUESHME

1. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Istogut para datës së publikimit të thirrjes publike;
2. OJQ-të të cilat veprojnë në Komunën e Istogut dhe realizojnë aktivitetin e njëjta të cekura sipas thirrjes.
3. OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit për të njëjtin aktivitet
4. Të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete
5. Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;

Shuma totale e thirrjes është 21.000 Euro për :

1.Shërbimin e rehabilitimit të bazuar në bashkësi Psiko-Terapi dhe Fizio-Terapi për fëmijët me aftësi të kufizuar deri në 15.000 Euro

2.Aftësimi i personave të verbër në teknologji informatike dhe braj deri në 6.000 Euro

- Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë nga dita e publikimit të thirrjes publike përkatësisht dita e fillimit është **14.01.2026** ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është me datën, **28.01.2026 ora 16:00.**
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me post ose personalisht, në zarf të mbyllur në zyrën e QSHQ (qendra për shërbim me qytetarë) në adresën “Komuna Istog, rruga Fadil Ferati, 31000”.
- Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në rregulloren për subvencione. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë të pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
- Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, por jo më vonë se tetë(8) ditë para mbylljes së thirrjes publike, duke dërguar email në adresën: drin.sadikaj@rks-gov.net

Kryetari i Komunës

z. Ilir FERATI

